



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria për Kulturë në Komunën e Prishtinës me qëllim të promovimit të solistëve të rinj dhe grupeve të reja muzikore të zhanreve të ndryshme, si dhe pasurimit të hapësirave publike me program kulturor ka marrë iniciativë të krijon hapësira dhe kushte të përshtatshme për performanca të gjalla para publikut të kryeqytetit. Me këtë rast Drejtoria për Kulturë u bënë

THIRRJE

Artistëve dhe interpretuesve që përmes regjistrimit në Komunën e Prishtinës të shprehin interesim për pjesëmarrje në këtë iniciativë.

Lokacioni i parë ku do të fillohet me këtë iniciativë është Shehi “Zahir Pajaziti”. Çdo të mërkure, të premte dhe të shtune gjatë muajit dhjetor do të vendoset bina e vogël, ndriçimi dhe zërimi, si dhe pajisjet tjera teknologjike për koncerte të vogla.

Për të qenë pjesë e kësaj iniciative, artistët skenik ose/dhe grupet muzikore fillimisht duhet të regjistrohen në Drejtorinë e Kulturës duke dërguar email me informatat si në vijim:

Për SOLIST/ individ

- Emri dhe mbiemri
- Zhanri i muzikës që interpreton
- Instrumenti
- Pjesëmarrja në koncerte apo festivale
- Biografia e shkurtë
- Kontakti (tel. dhe email)
- Interpreton këngë origjinale apo të huaja.
- Linqe në internet ku shihet performanca (nëse ka).

Për GRUPE MUZIKORE

- Emri dhe mbiemri i anëtarëve të grupit
- Zhanri i muzikës që interpretohet
- Instrumentet
- Pjesëmarrja në koncerte apo festivale
- Biografia e shkurtë e grupit
- Kontakti (tel. dhe email)
- Interpreton këngë origjinale apo të huaja
- Linqe në internet ku shihet performanca (nëse ka).

Kriteret për përzgjedhje janë:

- Programi që do të interpretohet (lista e këngëve dhe/ose veprave);
- Cilësia e interpretimeve të kaluara të prezantuar në materiale vizuale;
- Interpretimi duhet të respektoj audiencën;
- Interpretimi si kundër shpërblim llogaritet të jetë promovim artistik dhe në asnjë mënyrë kompensim tjetër (monetar, shërbim ose mall).

Kriteret refuzuese janë:

- dyshohet se interpretimet do të përmbajnë material i cili është ose konsiderohet të jetë shpifëse, i pahijshëm, ofendues, dhe në kundërshtim me standardet e mirësjelljes;
- ka baza të arsyeshme për të besuar për shkelje të te drejtave të pronës intelektuale të një pale të tretë.

Përzgjedhja e interpretuesve do të bëhet nga Komisioni për organizimin dhe identifikimin e artistëve në Komunën e Prishtinës. Prioritet, në kushte të barabarta, do t'i jepet solistëve dhe grupeve që janë regjistruar të parët.

Të përzgjedhurit do të kontaktohen nga zyrtarët e Drejtorisë për Kulturë rreth terminëve të përshtatshme për interpretim me ç' rast do të krijohet kalendari i interpretimeve të cilat do të publikohen në ueb faqen e Komunës dhe rrjetet sociale.

Kërkesa për regjistrim si dhe kërkesa për më shumë informata të dërgohet në email adresën drita.rudi@rks-gov.net.